



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 02.04.2025

Numër Protokolli: 2193/2025

A.nr.172/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.172/2025 të datës 22.01.2025 të parashtruar nga ankuesja L.M, kundër organit të punësimit Ministria Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.172/2025 të datës 22.01.2025 të parashtruar nga ankuesja L.M

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil L.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), me datë 22.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 455/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër njoftimit për kandidatin fitues të dates 24.12.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përbërja e komisionit ka qenë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) 15/2023 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil, përvoja e punës e kandidatit fitues është në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pra e gjithë përvoja është administrative teknike dhe asnjë ditë të vetme profesionale, kërkon që të anulohet Konkursi i jashtëm për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa me numër reference RN00015770 i datës 22.10.2024 i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.02.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa Këshilli më datë 20.02.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 04.03.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 22.10.2024 ka shpallë Konkursin me numër reference RN00015570 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa klasa e pozitës Drejtues i Ulët, ku afati për aplikim ka qenë nga data 23.10.2024 deri më 21.11.2024. Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me datë 18.11.2024 e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke plotësuar kriteret e konkursit dhe se i është nënshtruar fazës së testimit me shkrim të mbajtur me datë 17.12.2024, ku në testin me shkrim për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë gjithsejtë 36.2 pikë nga rrjedh se ankuesja nuk ka marrë pikët e mjaftueshme për t'iu nënshtruar fazës tjetër të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 24 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, dhe sipas njoftimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të datës 29.11.2024 për verifikim paraprak janë përfshirë katërmëdhjetë 14 kandidatë që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesja.

Pas përfundimit të fazave të vlerësimit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 24.12.2024 ka publikuar njoftimin për kandidatin fitues B.H. pikët e përgjithshme gjithsejtë 86.2 pikë.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër njoftimit për kandidatin fitues të dates 24.12.2024 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përbërja

e komisionit ka qenë në kundërshtim me Rregulloren (QRK) 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, përvoja e punës e kandidatit fitues është në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil pra e gjithë përvoja është administrative teknike dhe asnjë ditë të vetme profesionale, kërkon që të anulohet Konkursi i jashtëm për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa me numër reference RN00015570 i datës 22.10.2024 i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati V. Ç., si kandidatë aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015570, më datë 17.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.127/2025, të datës 14.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015570, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.172/2025 të datës 22.01.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.127/2025, të datës 14.03.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015570. Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankesë është bërë i pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.172/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.172/2025 të datës 22.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.172/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.M;
- Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.